KRONIKË E ZEZË

Arrestohet një i dyshuar për grabitje me armë

7 mars 2024, 17:21

Shpërndaje në

Një person është arrestuar në fshatin Ratkoc të Rahovecit i dyshuar për grabitje nën kërcënim të armës.

Sipas njoftimit, më 23 shkurt ishte raportuar për një rast të grabitjes me armë në këtë fshat ku të dyshuarit kishin arritur të marrin stoli ari dhe para të gatshme një grua dhe një burrë.

Në vendin e ngjarjes, në kohën e incidentit, ishte gjetur dhe sekuestruar një gëzhojë dhe një fishekë.

"Sektori i Hetimeve Rajonale i ngarkuar me hetimin e rastit, ka filluar me hetime intensive në drejtim të identifikimit dhe arrestimit të kryesve të rastit të raportuar. Fillimisht është arritur të identifikohet vetura e cila dyshohet të jetë përdorur nga të dyshuarit me rastin e kryerjes së grabitjes. Ndërsa me datën 05.03.2024, është zbatuar urdhër kontroll i lëshuar nga Gjykata në dy lokacione të ndryshme. Gjatë kontrollit një njërin lokacion është gjetur dhe sekuestruar një amë zjarri automatike e llojit AK47 me një karikatorë dhe dy copë fishekë, e cila dyshohet të jetë përdorur në rastin e grabitjes. Mbi dyshimin e përfshirjes në rastin e raportuar është arrestuar një i dyshuar i lindur në vitin 1994, me vendim të prokurorit të shtetit, në koordinim me të cilin janë ndërmarrë të gjitha veprimet hetimore, i njëjti është ndalur në mbajtje për 48 orë, ndërsa jemi në kërkim edhe të një të dyshuari tjetër të identifikuar, i lindur në vitin 1984", thuhet në njoftim.

© KOHA. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Klikoni këtu nëse dëshironi t'i lexoni lajmet e fundit dhe të përzgjedhura në kanalin tonë zyrtar në Viber

Dënohet me 25 vjet burgim i akuzuari për vrasjen e djalit për çështje pronësore
Vdes në QKUK fëmija që u aksidentua para dy javësh
Zhduket një grua në Skenderaj
Vdes një pacient në Spitalin e Gjakovës, Policia po e heton rastin
Një grua gjendet e vdekur në shtëpinë e saj në Podujevë
Arrestohet 72-vjeçari i dënuar për uzurpim të pronës
Policia në Vlorë gjen sasi të madhe armësh e municioni, arreston një të dyshuar

TaboolaFeed

Rusia shfaq hartën me Ukrainën brenda saj
Kohanet

Deklaratat e patriarkut serb në Tiranë
Kohanet

Kaos në Kuvendin e Malit të Zi, deputetët përplasen mes vete
Kohanet

Kim Jong Un urdhëron ushtrinë: Bëhuni gati për luftë
Kohanet

Putin: Serbia është aleate e veçantë dhe e besueshme
Kohanet

Policia suedeze kërkon që të ndalohet veshja e jelekëve antiplumb
Kohanet

TË TJERA

Aksident mes kamionit e veturës në rrugën Pejë-Prishtinë, tre të lënduar

Gjendet sasi e konsiderueshme barnash të kontrabanduara në veri

Aksion antidrogë, katër të arrestuar e konfiskohen sasi e heroinës, kokainës e marihuanës

"Kobra" deklarohet i pafajshëm për akuzën për vrasje, përjashtohet nga salla për prishje të rendit

BALLINA LAJME ZGJEDHJET 2021 KRONIKË KULTURË MES PËR MES VËSHTRIME SPORT HOROSKOPI PODCAST VIDEO MREKULLIA

KOHA

Marketing Politika e privatësisë Kushtet e përdorimit +383 (0) 38 249 105 info@koha.net Aneksi i ish-Radio Prishtinës (kati i parë) Xhorxh Bush p.n., 10000 Prishtinë

Partnerët: Shkabaj

Kjo faqe kontrollohet dhe menaxhohet nga KOHA. Të gjitha materialet në të, përfshirë fotografitë, janë të mbrojtura me copyright të KOHA-s dhe për to KOHA mban të drejtat e rezervuara. Materialet në këtë faqe nuk mund të përdoren për qëllime komerciale. Ndalohet kopjimi, riprodhimi, publikimi i paautorizuar qoftë origjinal apo i modifikuar në çfarëdo mënyre, pa lejen paraprake të KOHA-s. Shfrytëzimi i materialeve nga ndonjë faqe interneti a medium tjetër pa lejen e Grupit KOHA, në emër të krejt njësive që e përbëjnë (Koha Ditore, KohaVision, Koha.net, Botimet KOHA, KOHA Print dhe ARTA), është shkelje e drejtave të autorit dhe të pronës intelektuale sipas dispozitave ligjore në fuqi. Të gjithë shkelësit e këtyre të drejtave do të ballafaqohen me ligjin.

Përkthimi i përmbajtjeve në gjuhët tjera bëhet në mënyrë automatike dhe mund të ketë gabime!